

akti 246/2020
26.02.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 20, datë 26 / 02 /2020

MBI

**“SHPLLJEN E ZGJEDHJEVE TË REJA PËR ANËTARË TË KOMISIONIT
INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE SI DHE HAPJA E PROCEDURAVE PËR
APLIKIM PËR KOMISION APELIMI, NË UNIVERSITETIN
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” si dhe rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Arteve”, kreu II neni 6 pika 1, kreu VI neni 37, miratuar me vendim të Senatit Akademik Nr. 19, datë 10.02.2020, me votim të hapur unanimisht,

V E N D O S I:

1. Shpalljen e zgjedhjeve të reja për anëtar të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve si dhe hapjen e procedurave për aplikim për Komision Apelimi, në Universitetin e Arteve.
2. Kandidatët për anëtar të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve vetëkandidohen. Ato e dorëzojnë vetëkandidimin pranë Sekretarisë së Senatit Akademik të UART.
3. Kandidatët të cilët aplikojnë për anëtar të Komisionit të Apelimit duhet të përmbushin kriteret e mëposhtëm sipas Nemit 37, pika 2:
 - a) të kenë përvojë pune në mësimdhënie, jo më pak se 5 (pesë) vjet me kohë të plotë;
 - b) të mos jenë të dënuar asnjëherë për vepra penale me vendim të formës së prerë.
4. Afati për dorëzimin e dokumentacionit pranë Sekretarisë së Senatit Akademik është deri në datën 04.03.2020.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Dekanët e Fakulteteve dhe Sekretaria e Senatit Akademik.
6. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



